



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6.2 të Ligjit nr.05/L-120 për “Trepçën” SH.A., në Seancën plenare të mbajtur më 3 shkurt 2019, pas shqyrtimit të Propozim-Statutit të Shoqërisë Aksionare “Trepça”, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Statuti i Shoqërisë Aksionare “Trepça”.

Nr. 06-V- 317

Prishtinë, 03.02.2019

Kryetari i Kuvendit


Kadri VESELI

Vendimi dhe Statuti u dërgohen:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Drejtorisë për Çështje Ligjore dhe Procedurale dhe
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

VI Saziv
Prolećno zasedanje

Skupština Republike Kosova, na osnovu člana 65. (1) Ustava Republike Kosova i člana 6.2. zakona br. 05/L-120 o „Trepči“ D.D., na plenarnoj sednici održanoj 3. februara 2019. godine, nakon razmatranja Predlog-Statuta Deoničarskog Društva „Trepča“, donosi sledeću:

ODLUKU

Usvaja se Statut Deoničarskog Društva „Trepča“.

Br. 06-V- 317


Priština, 03.02.2019. godine

Predsednik Skupštine

Kadri VESELI

Odluka i Statut se prosleđuje:

- Vladi Republike Kosova,
- Direkciji za pravna i proceduralna pitanja, i
- Arhivi Skupštine.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Për: Deputetët e Kuvendit;
Cc: Kryesinë e Kuvendit;

Nga: Komisioni funksional për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal;

Lënda: Raport me Rekomandime për Projekt-Statutin e Trepça SH.A.;

Datë: 25.1.2019;

Komisioni për Zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti, industri dhe zhvillim rajonal (në tekstin e mëtejme: Komisioni), në bazë të nenit 62, të Rregullores së Kuvendit dhe në pajtim me nenin 6 paragrafi 2, i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.1.2019, shqyrtoi Projekt-Statutin e Trepça SH.A., dhe vendosi që Kuvendit, t'ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Projekt-Statuti i Trepça SH.A.;
2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.


Arsyetim

Në bazë të nenit 62, të Rregullores së Kuvendit, dhe nenit 6 paragrafi 2, i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, Komisioni Funksional, e shqyrtoj Projekt-Statutin e Trepça SH.A., të proceduar nga Qeveria dhe Bordi i Aksionareve të Trepça SH.A.

Komisioni, pas shqyrtimit, Projekt-Statutin e Trepça SH.A., vlerësojë së projekt-statuti i plotëson kushtet e parapara në nenin 6 paragrafi 2, i Ligjit Nr.05/L-120 për Trepçën, dhe i rekomandon Kuvendit për miratim.

Bashkëngjitur këtij rekomandimi: Projekt-Statuti Trepça SH.A

Kryetarja e Komisionit,
Sala BERISHA SHALA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

VI saziy

Prolečno zasedanje

Za: Poslanici Skupštine
Cc: Predsedništvo Skupštine
Od: Funkcionalna komisija za privredni razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju
Predmet: Izveštaj sa preporukom Nacrta statuta Trepče, d.d.
Datum: 25 januar 2019. godine.

Komisija za privredni razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju, (u daljem tekstu: „Komisija“), na osnovu člana 62 Poslovnika Skupštine, i člana 6 stav 2 Zakona o Trepči, na sednici od 25. 01. 2019. godine, razmatrala je Nacrt statuta Trepče d.d. te odlučila da Skupštini dostavlja

P r e p o r u k u

1. Preporučuje se Skupštini usvajanje Nacrta statuta Trepče d.d.;
2. Obrazloženje preporuke pred Skupštinom izneće predsednica Komisije Salja Beriša Šalja.

O b r a z l o ž e n j e

Shodno članu 62 Poslovnika Skupštine, i člana 6 stav 2 Zakona o Trepči, matična komisija razmatrala je Nacrt statuta Trepče d.d. te nakon njegovog razmatranja, ocenila je da isti ispunjava uslove predviđene članom 6 stav 2 Zakona o Trepči, i preporučila je Skupštini ga usvoji.

Preporuci je priložen Nacrt statuta o Trepči d.d.

Predsednica komisije,
Salja Beriša Šalja

PROJEKT - STATUTI

TREPÇA SH.A

Mbështetur në Ligjin Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Ligjin Nr. 05/L-120 për Trepçën, Ligjin Nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L – 009, Themeluesit e Shoqërisë Aksionare më datë 23.01.2019 nxjerrin:

STATUT PËR “TREPÇA” SH.A.

Neni 1 Qëllimi

Ky Statut ka për qëllim përcaktimin e themeluesve, të shoqërisë aksionare, aksionet e tyre, veprimtarinë, strukturën organizative, kapitalin themeltar, menaxhimin, afarizmin si dhe çështjet tjera organizative specifike të „Trepça” SH.A.

Neni 2 Themelimi dhe Emërtimi

1 .Sipas Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën si dhe Ligjin Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, themelohet, “TREPÇA”SH.A.

2. Shkurtimi i emërtimit të Shoqërisë është “TREPÇA”SH.A. Emërtimi i Shoqërisë Aksionare, me poshtë në këtë tekst e quajtur:”Shoqëria”, mund të shkruhet me shkronja të mëdha ose me shkronja të vogla.

Neni 3 Selia Qendrore

Selia e Shoqërisë“TREPÇA”SH.A. është Parku Industrial Mitrovicë (PIM) p.n.

Neni 4
Përfaqësitë dhe ushtrimi i aktivitetit të Shoqërisë

1. Shoqëria mund të hapë si në Republikën e Kosovës, ashtu edhe jashtë saj, qendra, përfaqësi apo filiale, degë dhe shoqëri të tjera, sipas këtij Statuti dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin e saj në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ashtu dhe jashtë saj.

Neni 5
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 6
Themeluesit

1. Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e 80% të aksioneve të shoqërisë me kapital publik, kurse pronarë të 20 % të aksioneve janë punëtorët, sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën.
2. Shoqëria themelohet në zbatim të Ligjit Nr. 05/L-120 për Trepçën; Ligjit Nr. 03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L – 009; dhe Ligjin Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.
3. Themelimi i „TREPÇA” SH.A., sipas paragrafit 2 të këtij neni, bëhet duke transformuar njësitë e veta biznesore si në vijim:
 - 3.1. Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg (Fi 690/89), përfshihen edhe vendburimet Melenica, Gjidom, Rashan, Mazhiq, Zijaça dhe Tërsten;
 - 3.2. Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë (Fi 349/88), përfshihen edhe vendburimet e Ajvalisë, Kishnicë, Badocit, Përroi i ngjyrosur, Kaltrina dhe Çuka e Batllavës;
 - 3.3. Minierat me Flotacion Kopaonik - Lepasaviç (Fi 804/89), përfshihen edhe vendburimet Cërnac, Bellobërdo, Gomile, Zhuta Perlino, Koporiç dhe Shotarica.
4. Në përbërje të Trepça Sh.A. formohen edhe këto njësi biznesore:
 - 4.1. Metalurgjia e Plumbit;
 - 4.2. Metalurgjia e Zinkut;
 - 4.3. Industria Kimike;
 - 4.4. Fabrika e Akumulatorëve në Mitrovicë;
 - 4.5. Fabrika e Pajimeve të Procesit;
 - 4.6. Stabilimentet energjetike (Energjetika);
 - 4.7. Laboratori në Zveçan;

- 4.8. Instituti i Plumbit dhe Zinkut;
- 4.9. Kompleksi administrativ i Kishnicës në Prishtinë;
- 4.10. Kompleksi administrativ në Zveçan.

5. Mbështetur në studimin e fizibilitetit mund të themelohen edhe njësi të tjera biznesore për përpunimin e metaleve, produkteve dhe shërbimeve të tjera.

6. Njësitë biznesore të Trepça Sh.A. formohen sipas ligjit për Trepçën dhe sipas vendimeve të Bordit Mbikëqyrës me propozim të Bordit Menaxhues në bazë të studimit të fizibilitetit.

7. Agjencia Kosovare e Privatizimit të mos inicoj ansjë procedurë për privatizimin apo likuidimin e ndonjë aseti të ndërmarrjes Trepça, pa marrë paraprakisht pëlqimin me shkrim nga Ndërmarrja Trepça sh.a. në lidhje me interesin e ndërmarrjes Trepça sh.a. për secilin aset veç e veç.

8. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale të mos lëshoj licencë operatorëve ekonomik brenda koordinatave të licencave të ndërmarrjes Trepça sh.a., duke marr parasysh paragrafin 3 të nenit 5 të Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën.

9. Qeveria e Republikës së Kosovës, të shqyrtoj mundësinë që në zhvillimin e zonave me interes të veçantë me përmbajtje të plumb-zinku, të trajtoj me prioritet përfshirjen e Ndërmarrjes Trepça sh.a.

Neni 7 Statuti

1 Statuti i Trepça Sh.A propozohet nga Bordi Mbikëqyrës, miratohet nga aksionarët pas aprovimit të Kuvendit të Kosovës.

2. Asetet e Shoqërisë përbëhen nga asetet e njërive biznesore të përcaktuara sipas të nenit 6 të këtij Statuti si dhe të nenit 2 të Ligjit për Trepçën.

3. Shoqëria themelohet vetëm pas regjistrimit të Shoqërisë në Agjencinë për Regjistrim të Bizneseve të Kosovës.

4. Ky Statut është dokument themelues dhe konstituiv i “TREPÇA” Sh.A. ndryshimet dhe plotësimet në Statut nuk kanë efekt juridik derisa të miratohen nga aksionarët pas aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe të dorëzohen në Agjencinë për Regjistrim të Bizneseve të Kosovës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 8 Rregulloret

1. Shoqëria duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë, sipas Ligjeve të Republikës së Kosovës.
2. Rregulloret miratohen, ndryshohen ose shfuqizohen nga aksionarët ose Bordi i mbikëqyrës, përveç nëse këto autorizime janë rezervuar vetëm për aksionarët në Statutin e shoqërisë. Asnjë rregullore e miratuar nga aksionarët nuk mund të ndryshohet ose shfuqizohet nga Bordi i Mbikëqyrës, përveç nëse kështu është përcaktuar në Rregullore.
3. Në rast të shfaqjes së konfliktit ndërmjet Statutit dhe rregulloreve të shoqërisë, Statuti i Shoqërisë mbizotëron mbi rregulloret. Në raste të tilla, dispozitat përkatëse të rregulloreve konsiderohen të revokuara ose të ndryshuara në masën e nevojshme për eliminimin e mospërputhjes.

Neni 9 Përgjegjësitë

Shoqëria është përgjegjëse për asetet, pasurinë, ajo gëzon të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara sipas Ligjit për Trepçën.

Neni 10 Aksionet

1. Shoqëria do të ketë listën e aksionarëve me të dhëna sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare
2. Aksionet janë të formës nominale, e thjeshtë ose e privilegjuar, të certifikuara ose të pa certifikuara, të letrave me vlerë, si dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, i cili rregullon marrëdhëniet tregtare.
3. Vlera e aksionit të thjeshtë të TREPÇA Sh.A është 1 (një) Euro.
4. Pronësia mbi aksionet, rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të pronarit, në librin e aksioneve të mbajtura nga ana e shoqërisë, apo ndërmjetësve financiarë.
5. Aksionet e shoqërisë, zotërohen në masën 80% nga Qeveria e Kosovës, ndërsa pronarë të 20% të aksioneve janë punëtorët të cilat përcaktohen me udhëzim të veçantë administrativ.
6. Përqindja e pjesëmarrjes në 20% të aksioneve, për secilin punëtor veç e veç, përcaktohet duke e përlllogaritur sipas vlerës së aseteve të njësisë biznesore ku punëtori ka marrëdhënie pune të përcaktuara me udhëzim të veçantë administrativ.

7. Më rastin e shitjës së aksioneve, aksionarët që sipas Ligjit Nr.05/-120 për Trepçën kanë 20% të aksioneve – punëtorët, obligohen që ofertën e parë të ia paraqesin aksionarëve tjerë të ndërmarrjes e që sipas të njëjtit ligj kanë 80% të aksioneve – Qeveria e Republikës së Kosovës. Vlera e shitjës së aksioneve nuk mund ta tejkaloj vlerën e tregut.

Neni 11 **Veprimtaria**

1. Qëllimi kryesor i Shoqërisë është të jetë profitabile (maksimizoj profitin).
2. Aktivitetet kryesore të Shoqërisë janë:
 - 2.1. Kërkimi, zbulimi dhe zhvillimi i vend burimeve minerale;
 - 2.2. Ndërtimi, operimi dhe mirëmbajtja e objekteve sipërfaqësore, punimeve nëntokësore dhe strukturave të projektuara për kërkimin, zbulimin dhe zhvillimin e vendburimeve minerale, si dhe shfrytëzimi dhe përpunimi i mineraleve të xeheroreve dhe mineraleve joxeherore;
 - 2.3. Zhvillimi i projekteve dhe dokumentacioneve teknike për minierat dhe objektet ekzistuese;
 - 2.4. Operimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve, mekanizmit, mjeteve të komunikacionit dhe mjeteve të transportit si dhe garantimi i sigurisë të mjeteve të prodhimit dhe personelit;
 - 2.5. Operimet e minimit;
 - 2.6. Operimi i magazinimit të përhershëm të eksplozivit dhe pajisjeve të shpërndarjes së eksplozivit;
 - 2.7. Grumbullimi i xehës, transportimi i xehës së grumbulluar, operimi në flotacion;
 - 2.8. Shitjet e metaleve primare të prodhuara përmes përpunimit të mineraleve;
 - 2.9. Shitjet e xehes dhe koncentreve të xehes;
 - 2.10. Procesimi metalurgjik i xehes, koncentratit të xehes, metaleve me ngjyrë, metaleve të lindur, metaleve të rralla dhe metaleve të çmuara, prodhimin e baterive, sulfurit, acidit sulfurik, plehrave azotike.
 - 2.11. Gjenerimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë gjeotermale;
 - 2.12. Magazinimi dhe ruajtja e lëndëve djegëse;

- 2.13. Operimi me ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë të krijuar, procesi/furnizimi me ujë të pijshëm dhe sistemet e ujit me qark të mbyllur;
- 2.14. Operimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të komunikimit telefonik dhe radio-lidhjeve;
- 2.15. Operimi dhe mirëmbajtja e deponive;
- 2.16. Montimi, rregullimi dhe funksionimi i pajisjeve të furnizimit me energji elektrike / termike;
- 2.17. Transporti i pasagjerëve dhe garkesave me rrugë motorike dhe hekurudha;
- 2.18. Ndërtimi, rindërtimi, riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve motorike, hekurudhave dhe infrastruktures së trafikut;
- 2.19. Punët dhe shërbimet e mbrojtjes së mjedisit;
- 2.20. Operacionet e sigurisë nga zjarri;
- 2.21. Zhvillimi i dokumentacionit urbanistik;
- 2.22. Aktivitetet arkitekturale;
- 2.23. Shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe trajtimin mjekësor;
- 2.24. Operacionet e projektimit dhe eksplorimit, duke përfshirë ato që lidhen me përdorimin e tokës;
- 2.25. Punë topografike, gjeodezike dhe hartografike të lidhura me minierat dhe ndërtimet;
- 2.26. Vëzhgime inxhinierike të kërkuara për ndërtimin, projektimin dhe montimin e ndërtesave dhe objekteve;
- 2.27. Operimi i sistemeve inxhinierike urbane dhe lokale;
- 2.28. Shërbimet arsimore arsimi i mesëm/ shkollave të mesme, arsimi i lartë, arsimi profesional pasuniversitar dhe trajnimet plotësuese përkatëse);
- 2.29. Rafinimi/Përpunimi i metaleve të çmuara;
- 2.30. Matjet/studime gjeologjike, ndërtimi dhe publikimi i hartave gjeologjike, duke përfshirë harta dhe tabela digjitale;
- 2.31. Shpimet kërkimore për hulumtimin e ujit dhe mineraleve tjera të ngurta;
- 2.32. Operacionet e eksportit dhe importit të rregulluara me ligjet e Republikës së Kosovës;

2.33. Investime në kapitalin aksioner të kompanisë dhe fondet e huazuara, duke përfshirë fondet në valutë të huaj, në sipërmarrje të përbashkëta me organizatat në Kosovë dhe jashtë saj, kompanitë dhe individët, duke përfshirë krijimin e filialeve në Kosovë dhe jashtë saj;

2.34. Trajnimi i personelit profesionet kyçe për operacionet dhe objektet e minierave dhe prodhimit industrial

3. Për të arritur objektivat e saj të biznesit, Shoqëria ka të drejtët kryejë aktivitete të tjera afariste përveç atyre të ndaluara nga ligjet e Republikës së Kosovës.

4. Veprimtaria e TREPÇA SH.A, mes tjerash, është si në vijim:

0729 Nxjerrja e xeheve metalore me ngjyrë (jo-ferrike): Primar

0729 Nxjerrja e xeheve të tjera metalore Sekundar:

0811 Nxjerrja e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gjipsit, shkumësit dhe rrasave: Të tjera

0891 Nxjerrja e mineraleve kimike dhe plehërave kimikë;

0899 Aktivitetet e tjera nxjerrëse dhe gurëthyese p.k.t;

0990 Aktivitetet mbështetëse për nxjerrjen e produkteve të tjera nga nëntoka;

2013 Prodhimi i produkteve të tjera kimike me bazë inorganike;

2014 Përpunimi i produkteve të tjera kimike me bazë organike;

2015 Prodhimi i plehrave kimike dhe komponimeve të azotit;

2030 Prodhimi i ngjyrave, llaqeve dhe shtresave të ngjashme, ngjyrave të printimit dhe mastikës;

2059 Prodhimi i produkteve të tjera kimike p.k.t;

2110 Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike;

2370 Thyerja e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare;

2399 Prodhimi i produkteve minerale jometalike p.k.t.;

2441 Prodhimi i metaleve të çmuara;

2443 Prodhimi i plumbit, zinkut dhe kallajit;

2445 Prodhimi i metaleve të tjera jo-ferrike;

2453 Derdhja (fonderia) e metaleve të lehta;

2454 Derdhja (fonderia) e metaleve të tjera jo-ferrike;

2550 Farkimi, presimi, stampimi dhe palosja rrethore e metaleve; pluhuri metalurgjik;

2562 Përpunimi mekanik;

2573 Prodhimi i veglave;

2599 Prodhimi i produkteve të tjera metalike p.k.t;

2720 Prodhimi i baterive dhe akumulatorëve;

2830 Prodhimi i makinerive bujqësore dhe pyjore;

2841 Prodhimi i makinerive për punimin e metaleve;

2849 Prodhimi i veglave të tjera të makinave p.k.t;

2891 Prodhimi i makinerive për metalurgjinë;

2892 Prodhimi i makinerive për miniera, gurëthyes dhe ndërtimtari;

2920 Prodhimi i karrocërve për mjetet motorike (të transportit): prodhimi i rimorkiove dhe gjysmërimorkiove;

3312 Riparimi i makinerive;

3320 Instalimi i makinerive dhe pajisjeve industrial;

3832 Rikuperimi i materialeve të klasifikuara;

4110 Zhvillimi i projekteve të ndërtimit;

4312 Përgatitja e vendpulishtes;

4313 Testi i shpuarjes dhe shpuarja;

4322 Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit;

4612 Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e karburantit, mineraleve, metaleve dhe kimikateve industriale;

4672 Tregtia me shumicë e metaleve dhe mineraleve;

4675 Tregtia me shumicë e produkteve kimike;

4677 Tregtia me shumicë e mbeturinave dhe hekurishteve;

5221 Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor;

5629 Aktivitetet e tjera shërbyese të ushqimit;

6820 Qiradhënia dhe menaxhimi i patundshmërisë personale ose të marra me qira;

7111 Aktivitetet e arkitekturës;

7112 Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik;

7120 Testimi teknik dhe analizat;

7219 Kërkime dhe zhvillime të tjera eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinieri;

7490 Aktivitetet e tjera profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t;

7830 Sigurimi i burimeve njerëzore dhe menaxhimi i funksioneve të burimeve njerëzore;

8621 Aktivitetet e mjekësisë së praktikës së përgjithshme;

9101 Aktivitetet e bibliotekave dhe të arkivave;

9102 Aktivitetet e muzeve.

5. Shoqëria, ndër të tjera, ka për detyrë të ushtroj veprimtarinë e vet, sipas Ligjit për Trepçën si dhe legjislacionit në fuqi për ndërmarrjet publike.

Neni 12

Mënyra e funksionimit të njësive biznesore

1. Njësitë biznesore kryejnë funksionet e veta të përcaktuara sipas Ligjit për Trepçën si ligjeve të tjera përkatëse për ndërmarrjet publike.

2. Mënyra e funksionimit të njësive biznesore, sipas paragrafit 1 të këtij neni, bëhet duke menaxhuar aktivitetet e veta, mbi bazën e kompetencave të përcaktuara me ligj, dhe me Statut të Trepça sh.a.

3. Njësitë biznesore propozojnë planet, projektet investuese me aprovim të Bordit Mbikëqyrës.

4. Njësitë biznesore do të kenë të evidentuara nënlogari bankare të ndara, për të marrë vendime lidhur me pagat dhe shpenzimet operative sipas planeve financiare të aprovuara nga Bordi Mbikëqyrës.

Neni 13 **Kapitali themeltar dhe pasuria**

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është dhjetëmijë (10.000) Euro dhe është i ndarë në dhjetëmijë (10.000) aksione me vlerë nominale një (1) Euro secili. Kapitali i Shoqërisë është derdhur dhe nënshkruar tërësisht.

2. Aksionari i Shoqërisë është Qeveria e Republikës së Kosovës dhe punëtorët e Shoqërisë.

3. Të gjitha ndryshimet e kapitalit themeltar, bëhen sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin Nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, ku përfshihet shuma, parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themeltar, zvogëlimi i kapitalit themeltar, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksioneve, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themeltar, riblerja ose revokimi i aksioneve etj.

Neni 14 **Shpërndarja e dividendit**

1. Bordi Mbikëqyrës i TREPÇA'' SH.A përcakton dividendin sipas Ligjit për Trepçën.

2. Shpërndarja e dividendit do të bëhet vetëm me autorizim të aksionarit, në bazë të Statutit si dhe sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

3. Dividendi që u takon aksionarëve sipas pjesëmarrjes së tyre në aksione evidentohet dhe paguhet në nivel të njësisë biznesore duke u bazuar në rezultatin financiar të saj.

Neni 15 **Aksionarët** **Regjistri i Aksionarëve**

1. Shoqëria duhet të themeloj dhe të mirëmbajë Regjistrin e Aksionarëve, në pajtueshmëri me Ligjin për Trepçën dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Regjistrat e tillë duhet të përmbajnë informatat e kërkuara në bazë të ligjit si dhe çfarëdo informate tjetër që Shoqëria mendon se është e nevojshme.

2. Shoqëria nuk do t'i ngarkoj me taksë për regjistrimin e çfarëdo transferi apo dokumenti tjetër në lidhshmëri me/apo i cili dëmton titullarin e ndonjë aksioni.

3. Personi i autorizuar (Sekretari i Trepça sh.a.) do të regjistrojë transferin e ndonjë aksioni vetëm kur ti ofrohet dëshmia mbi transferin në përputhje me Ligjin.

Neni 16

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve

1. Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të Shoqërisë ("Mbledhja e Përgjithshme") është trupi më i lartë vendim-prurës i Shoqërisë. Vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme, të cilat konsiderohen vendime, janë të obligueshme për Shoqërinë, aksionarët, dhe zyrtarët tjerë të Shoqërisë.

2. Thirrja dhe Agjenda e Mbledhjes së Përgjithshme:

2.1. Shoqëria duhet të mbajë një Mbledhje të Përgjithshme Vjetore ("Mbledhja e Përgjithshme Vjetore") që të rishikojnë dhe të aprovojnë pasqyrat financiare vjetore, brenda njëqind e njëzet (120) ditëve pas mbylljes së vitit financiar të Shoqërisë.

2.2. Mbledhjet e Përgjithshme thirren nga Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës, përmes Sekretarit të Shoqërisë.

3. Mbledhjet e Përgjithshme mund të thirren nga Bordi Mbikëqyrës kurdo që të paraqitet nevoja, në mënyrë të barabartë Bordi Mbikëqyrës mund të përfshij çështjet shtesë në agjendën e Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore.

4. Sipas rregullave të përcaktuara çështjet shtesë mund të përfshihen në agjendën e Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore, një kërkesë e tillë mund të mos përfillet në rast se dorëzohet jo më vonë se njëqind (100) ditë pas mbylljes së vitit financiar të Shoqërisë. Nëse një kërkesë e tillë bëhet pasi të jetë dërguar njoftimi për mbledhje, Mbledhja e Përgjithshme Vjetore duhet të shtyhet dhe njoftimi i ri duke përfshirë edhe çështjet shtesë të agjendës duhet të dërgohen.

Neni 17

Njoftimi i Mbledhjes së Përgjithshme dhe Procedimet

1. Njoftimi për një Mbledhje të Përgjithshme duhet t'i dërgohet secilit aksionar së paku tridhjetë (30) ditë më herët në adresat e listuara për secilin aksionar në regjistrin e aksionarëve si dhe secilit anëtar të Bordit Mbikëqyrës. Për më tepër, njoftimi duhet të bëhet përmes publikimit ashtu siç kërkohet me ligj.

2. Njoftimi duhet të përfshijë kohën dhe vendin e Mbledhjes së Përgjithshme dhe agjendën. Njoftimi duhet të njoftoj se nëse ndonjë palë nuk do të jetë prezent në Mbledhjen e Përgjithshme atëherë kjo e fundit mund të shtyhet për më vonë për ndonjë datë më të përshtatshme, duke përcaktuar kohën dhe vendin: një datë e tillë nuk mund të jetë më herët se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës së caktuar për mbledhjen e as tridhjetë (30) ditë pas saj.

3. Dështimi për ta njoftuar për Mbledhjen e Përgjithshme secilin aksionar mund të eliminohet nëse ai person merr pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme personalisht apo i autorizuari i tij. Dështimi për ta njoftuar për Mbledhjen e Përgjithshme secilin anëtar të Bordit Mbikëqyrës mund të eliminohet nëse shumica e anëtarëve të Bordit Mbikëqyrës marrin pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme personalisht.

4. Secila kërkesë për njoftim do të konsiderohet e braktisur nëse Mbledhja e Përgjithshme vepron sipas vendimit të shkruar dhe nëse është e nënshkruar nga të gjithë Anëtarët e pranishëm.

5. Mbledhjet e Përgjithshme mund të mbahen në më tepër se një lokacion përmes lidhjes së ndërsjellë me zë apo video-konferencë, përderisa kërkesat në vijim plotësohen dhe pasqyrohen në procesverbalet përkatëse:

6. Udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme duhet të jetë në gjendje të përcaktoj identitetin dhe të drejtën e participimit të atyre që janë prezent, duhet të udhëheqë Mbledhjen e Përgjithshme dhe duhet të përcaktoj dhe të deklaroj rezultatet e votimit;

7. Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë për pikat e agjendës, gjithashtu të lexojnë, të pranojnë apo të dërgojnë dokumentet e ndërlidhura (nëse ka ndonjë).

8. Kuorumi për Mbledhjet e Përgjithshme

8.1 Mbledhja e Përgjithshme mund të mbahet vetëm nëse kuorumi është prezent personalisht apo përmes të autorizuarit. Sekretari duhet të kryej aranzhimet e nevojshme që aksionarët të regjistrojnë aksionet e tyre në Mbledhjen e Përgjithshme. Kuorumi duhet të jetë prezent nëse aksionarët (apo agjentët e tyre të autorizuar) duke përfaqësuar së paku pesëdhjetë (50%) për qind të aksioneve votues të Shoqërisë janë të regjistruar si prezent në Mbledhjen e Përgjithshme.

8.2 Nëse nuk ka kuorum përbrenda një periudhe të arsyeshme kohore pas kohës së përcaktuar për fillim, Mbledhja e Përgjithshme duhet të ndërpritet apo të shtyhet për një datë të përshtatshme që është e përcaktuar në njoftim (nëse ka). Që një Mbledhje e tillë e Përgjithshme të shtyhet, kuorumi duhet të jetë njëzetë e pesë për qind (25%) e pjesës votuese të Shoqërisë. Nëse në Mbledhjen e Përgjithshme të shtyrë nuk ka kuorum brenda një periudhe të arsyeshme kohore para fillimit të mbledhjes, Mbledhja e Përgjithshme do të anulohet.

9. Mbledhjen e Përgjithshme mund ta udhëheqë:

9.1. Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës apo personi i zgjedhur me vendim të aksionarëve nga shumica e pjesëmarrësve prezentë në Mbledhjen e Përgjithshme. Udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme duhet të veproi arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këtë statut. Të konstatoj prezencën e kuorumit, të drejton debatin, të caktoj personin për mbajtjen e procesverbalit dhe të konstatojë e deklaron rezultatet e votimit. Sekretari do të asistojë Kryesuesin (udhëheqësin).

10. Votat e Aksionarëve

10.1. Secili aksionarë i regjistruar në regjistrin e aksionarëve të Shoqërisë do të ketë të drejtën për një votë për secilin aksion për të cilin ai është mbajtës dhe duhet të informohet tridhjetë (30) ditë para mbajtjes së Mbledhjes së Përgjithshme.

10.2. Vota e dhënë nga i autorizuari duhet të jetë e vlefshme, pa marrë parasysh shkarkimin e mëhershëm të autoritetit të personit votues.

10.3. Çdo vendim i vënë në votim në Mbledhjen e Përgjithshme duhet të vendoset me numërim të hapur publik. Numërimi duhet të fillojë menjëherë kur udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme udhëzon, në atë mënyrë që mundëson votimet që i përkasin secilit aksion për apo kundër vendimit që të numërohet në mënyrë të saktë. Në rast se votat e anëtarëve prezent janë barabarta, udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme (nëse ai apo ajo është aksionar) mund të ketë votë vendimtare.

10.4. Aksionarët në Mbledhjen e Përgjithshme mund të miratojnë vetëm vendimet në lidhje me çështjet të cilat janë në agjendë, përveç për ndonjë Mbledhje Përgjithshme të jashtëzakonshme, nëse aksionarët të cilët përfaqësojnë të gjitha aksionet e Shoqërisë e të cilët kanë të drejtë të votojnë janë prezent dhe pajtohen ndryshe.

10.5. Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë aksionarët e Shoqërisë do të ketë të njëjtën fuqi sikurse edhe vendimi që ka kaluar në Mbledhjen e Përgjithshme. Vendimet tilla mund të përbëhet prej disa dokumenteve duke pasur formë dhe përmbajtje identike, secili i nënshkruar nga një ose më tepër aksionar.

11. Kompetencat e Mbledhjes së Aksionarëve

11.1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në ligj, Mbledhja e Përgjithshme e aksionarëve duhet të ketë kompetenca ekskluzive të:

11.1.1. Ndryshoj statutin dhe aktet nënligjore të Shoqërisë, miratojnë kodet e qeverisjes së përbashkët të Shoqërisë, përcaktojnë kriteret për ushtrimin e organeve drejtuese të Shoqërisë si dhe vendimet në përputhje me ky statut dhe legjislacionin në fuqi.

11.1.2. ngritjen apo zvogëlimin e vlerës së aksioneve të Shoqërisë;

11.1.3. Themeloj shkallë të ndryshme të aksioneve, të përcaktoj të drejtat e tyre dhe tiparet e tjera dhe ti ndryshoj ato;

11.1.4. Vendos për ndonjë bashkim, konsolidim, ndarje, shpërndarje, likuidim, transformim dhe deri në atë masë të lejuar me ligj – në bankrotim apo insolvencë (pa aftësi paguese) të Shoqërisë

11.1.5. Vendosë për lëshimin e aksioneve, lëshimin e borxhit apo sigurimeve të konvertuara në aksione si dhe konsolidimin apo ndarjen e aksioneve të pa paguara dhe sigurimeve konvertuese;

11.1.6. Emëron, largon apo zëvendëson anëtarët e Bordit Mbikëqyrës;

11.1.7. Përcakton pagesat shtesë për ata drejtorë të cilët gjithashtu janë anëtarë të komisionit të auditimit;

11.1.8. Emëron–me propozim të komisionit të auditimit largon apo zëvendëson auditorët e jashtëm të Shoqërisë dhe përcakton pagesat e tyre, në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi;

11.1.9. Autorizon çfarëdo transaksioni në mes të Shoqërisë dhe cilitdo drejtor dhe ofrimin e çfarëdo shërbimi për Shoqërisë nga auditorët e saj të jashtëm përveç shërbimit të auditimit të ofruar me këtë statut dhe

11.1.10. Aprovon pasqyrat financiare vjetore si dhe dokumentet e tjera të parapara, deklaron të gjithë dividendën dhe vendos në mbulimin e çfarëdo humbjeje.

12. Të gjitha vendimet sipas paragrafit 11.1.1, 11.1.2, 11.1.3., 11.1.4, 11.1.5., 11.1.6., 11.1.7. 11.1.8. ,11.1.9. dhe 11.1.10. sipas këtij neni duhet të kërkojnë votën e 2/3 apo 67% të aksioneve.

12.1 Çështjet të cilat janë në kompetencën ekskluzive të aksionarëve, siç është paraparë në këtë nen, nuk mund të vendosen nga Bordi Mbikëqyrës, Bordi Menaxhues, ose zyrtarët/menaxherët ose nga cilido organ tjetër i Shoqërisë. Dispozitat kundërthënëse në statut ose rregullore, si dhe çfarëdo vendimi i marrë në bazë të këtyre dispozitave kundërthënëse, nga aspekti juridik, është i pavlefshëm dhe nuk ka efekt juridik.

Neni 18 **Qeverisja e Shoqërisë**

1. Qeverisja e Shoqërisë përbëhet nga:

1.1. Bordi Mbikëqyrës;

1.2. Bordi Menaxhues.

Neni 19 Bordi Mbikëqyrës

1. Veprimtaria dhe detyrat e Shoqërisë do të drejtohen nga Bordi Mbikëqyrës, siç është përcaktuar në këtë Statut, Ligjin për Trepçën, Ligjin për Shoqëritë tregtare si dhe legjislacioni ne fuqi për ndërmarrje publike.

2. Bordi Mbikëqyrës, përveç kompetencave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, sipas Ligjit për Trepçën dhe ndërmarrjet publike ka edhe këto detyra dhe përgjegjësi si ne vijim:

- 2.1. aprovon planet financiare dhe zhvillimore të njësive biznesore;
- 2.2. aprovon kontratat lidhur me partneritetin; si dhe
- 2.3. zgjedh anëtarët e Bordit Menaxhues;
- 2.4. marrja e Vendimeve mbi të gjitha çështjet, e shoqërisë;
- 2.5. zbatimi dhe respektimi i statutit të shoqërisë si dhe akteve të tjera nënligjore në pajtueshmëri me Ligjin;
- 2.6. miratimi i planeve afariste strategjike të Shoqërisë;
- 2.7. konvokimin e mbledhjeve vjetore dhe të jashtëzakonshme;
- 2.8. përgatitjen e agjendës fillestare të mbledhjes;
- 2.9. emetimin e aksioneve brenda kufizimeve të parapara në këtë Statut;
- 2.10. mundësinë për blerjen e aksioneve apo letrave me vlerë;
- 2.11. punësimi i zyrtarëve;
- 2.12. vendosjen e shpërblimit dhe kushtet tjera të marrëveshjes me auditorin e shoqërisë ose auditorin e jashtëm të pavarur;
- 2.13. përcaktimin e shumave dhe caktimin e datave të pagesës dhe procedurat për pagesën e dividendeve;
- 2.14. miratimin e raportit vjetor të shoqërisë dhe vlerësimin vjetor të fitimit dhe humbjeve të cilat pastaj dorëzohen tek aksionarët për miratim;
- 2.15. vendosjen për të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me kompetencën ekskluzive të Bordit Mbikëqyrës të përcaktuar me këtë Statut; si dhe ,
- 2.16. detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin ne fuqi për ndërmarrjet publike.

3. Bordi Mbikëqyrës, zgjidhet nga aksionarët përpjesëtimisht me pjesëmarrjen në kapital, në bazë të Ligjit për Trepçën, sipas procedurave të përcaktuar me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.

4. Bordi Mbikëqyrës i TREPÇA Sh.A. përbëhet nga nëntë (9) anëtarë, si në vijim:

z. <u>Ardian Syla,</u>	<u>kryesues.</u>
z. <u>Naser Peci,</u>	<u>anëtar.</u>
z. <u>Feriz Fetahu,</u>	<u>anëtar.</u>
z. <u>Xhafer Nuli,</u>	<u>anëtar.</u>
z. <u>Shyqyri Sadiku,</u>	<u>anëtar.</u>
z. <u>Esat Peci,</u>	<u>anëtar.</u>
z. emri dhe mbiemri, _____	<u>anëtar.</u>
z. emri dhe mbiemri, _____	<u>anëtar.</u>
z. emri dhe mbiemri, _____	<u>anëtar.</u>

5. Lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me themelimin, funksionimin dhe shuarjen e njëjësive biznesore ose investimet në projekte të reja, Bordi Mbikëqyrës duhet të marrë pëlqimin Qeverisë së Republikës së Kosovës si aksionari kryesor.

6. Bordi Mbikëqyrës udhëhiqet nga parimet e qeverisjes korporative të transparencës, llogaridhënies, efikasitetit dhe efektivitetit, kompetencës profesionale dhe pavarësisë.

Neni 20

Mbledhjet e Bordit Mbikëqyrës

1. Bordi Mbikëqyrës mban një mbledhje të rregullt e cila njihet si mbledhje vjetore menjëherë pas çdo mbledhje vjetore të aksionarëve. Mbledhjet tjera të rregullta mbahen në kohën dhe vendin të cilin e cakton Bordi në mbledhjen vjetore ose në një mbledhje të Bordit për të cilën janë njoftuar të gjithë anëtarët.

2. Njoftimi për mbledhje duhet të ketë agjendën dhe duhet të dorëzohet në kopje fizike apo elektronike tri ditë para mbledhjes. Në raste të ndonjë emergjenc, njoftimi për mbledhjen duhet të përcjellët me letër dhe të dërgohet në kopje fizike apo elektronike, së paku një ditë para mbledhjes.

3. Në mbledhje, Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës, duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këtë Statut, duhet të përcaktoj praninë e kuorumit, të drejtoj debatin, si dhe të mbaj procesverbalin dhe të përcaktoj dhe deklaroj rezultatet e votimit.

4. Mbledhjet e Bordit Mbikëqyrës kanë validitet nëse prezantojnë shumica e Bordit dhe duhet të veprohet me votën pohuese të shumicës së anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje. Anëtarët të cilët mund të abstenojnë nga votimi dhe anëtarët të cilët kanë shpalosur konflikt interesash nuk do të përfshihen në numërim në lidhje me shumicën. Në rast barazimi me vota, Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës duhet të ketë votën vendimtare.

5. Nëse, numri i anëtarëve është më i vogël se numri i vendosur si kuorum, anëtarët e mbetur (apo anëtari) mund të veprojnë vetëm për qëllim të thirrjes së mbledhjes për plotësimin e vendeve të lira.

Neni 21

Bordi Menaxhues

1. Bordi Menaxhues i Shoqërisë ka për detyrë menaxhimin e Shoqërisë, i cili udhëheq me politikatat operative, dhe është përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm biznesor të Shoqërisë.

2. Bordi Menaxhues i Shoqërisë, përbëhet nga :

2.1. Kryeshefi ekzekutiv i Trepça Sh.A;

2.2.Zëvendësi i tij; si dhe,

2.3. Udhëheqësit e njësisive biznesore.

Neni 22

Zyrtarët e Shoqërisë

1. Zyrtarët e shoqërisë, përveç Kryeshefit Ekzekutiv do të jenë edhe zyrtari financiar, zyrtari i auditimit të brendshëm, sekretari si dhe zyrtarë të tjerë të caktuar nga Bordi Mbikëqyrës.

2. Kryeshefi Ekzekutiv i Shoqërisë do të ketë autoritet që të lidh kontrata për Shoqërinë në pajtueshmëri me Statutin si dhe aktet ligjore dhe nënligjore, përveç kufizimeve të përcaktuara nga Bordi Mbikëqyrës.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë dhe organizimi i Shoqërisë kryhet nga Kryeshefi Ekzekutiv në pajtueshmëri me Statutin aktet ligjore dhe nënligjore si dhe vendimet e Bordit Mbikëqyrës.

4. Kryeshefi Ekzekutiv do të ketë të drejtë të punësoj apo të largoj nga puna zyrtarët apo stafin e shoqërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Kryeshefi Ekzekutiv ndër të tjera ka edhe këto detyra si:

5.1. Këshillon dhe asiston Bordin në përcaktimin e Strategjisë së shoqërisë si dhe planet e saja strategjike afatgjata;

5.2. Propozon Bordit kandidatë të përshtatshëm për punësim, duke respektuar dispozita ligjore në fuqi.

5.3.T ë ofroj kurdo që është e nevojshme Bordit raporte për transaksionet të ndërmarra nga Shoqëria në lidhje me udhëheqjen e Shoqërisë, si dhe çështje të tjera të përcaktuara në Statut dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 23

Komisioni i Auditimit

1 .Komisioni i Auditimit formohet nga Bordi Mbikëqyrës sipas Ligjit për Trepçën i cili do të veproj në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe do ketë përfaqësim proporcional në bazë të aksioneve.

2. Bordi Mbikëqyrës mund të themelojë komitete/komisione të përhershme ose të përkohshme nga kompetenca dhe fushë veprimtaria e vet.

3. Bordi Mbikëqyrës do të angazhojë një auditor të jashtëm të pavarur me reputacion ndërkombëtar i cili do të raportojë tek aksionarët lidhur me pasqyrat financiare të njësive biznesore të Trepça Sh.A.

4. Komisioni i Auditimit zgjedh Zyrtarin Kryesor të Auditimit të Brendshëm.

Neni 24 **Detyrat e Besuara**

1. Çdo Drejtor dhe Zyrtar i Shoqërisë do të kenë detyra të lëna në mirëbesim për Shoqërinë në përputhje me ligjin. Këto detyra në mirëbesim gjithmonë do përfshijnë detyrat që të:

1.1. Veprojnë në besim të mirë ekskluzivisht për përfitime kolektive dhe për përfitime objektive të aksionarëve gjithmonë në përputhje me ligjin dhe statutin;

1.2. Të ushtroj kompetencat që iu është dhënë atyre ekskluzivisht në përputhje me interesat më të mira kolektive dhe objektive të aksionarëve;

1.3. Të ketë konsideratë adekuate për çështjet që duhet vendosur nga ata dhe të sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve të tilla, duke pasur parasysh ndërlíkueshmërinë e tyre;

1.4. Të shmang dhe shpalos konfliktet aktuale dhe potenciale në mes të interesave të tyre personale (direkte apo indirekte) dhe të interesave të Shoqërisë;

1.5. Të ushtrojnë kujdes të arsyeshëm, zell dhe aftësi gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre; dhe

1.6. Të trajtojnë si konfidenciale të gjitha informatat të pranuar me arsye nga zyra e tyre ose gjatë zbatimit të detyrave të tyre.

Neni 25 **Detyrimi për mos konkurrencë**

1. Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës, si dhe anëtarët e Shoqërisë nuk mund direkt apo indirekt, të rregullt apo përkohësisht, për llogari të vet apo tjetërkujt të kryejnë punë në Shoqëritë tjera tregtare apo tjera të cilat punë Shoqëria i ka të parapara në veprimtarinë e vet. Po ashtu ata nuk mund të kenë aksione tjera në Shoqëritë tjera dhe as të jenë anëtarë të Shoqërive të tilla, nëqoftëse atë veprimtari paraprakisht nuk ia lejon Bordi Mbikëqyrës.

2. Nëse anëtari i Shoqërisë vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni, Shoqëria mundet të kërkojë kompensimin e dëmit të shkaktuar.

Neni 26

Rezervat e shoqërisë

1. Shoqëria është e obliguar që të krijoj rezervat obligative. Mbi formimin e rezervave obligative kujdeset Bordi Mbikëqyrës.
2. Në rezervat obligative futen 5% e fitimit deri sa rezervat nuk arrijnë lartësinë 10% të kapitalit themeltar. Pas arritjes së asaj lartësie, rezervat obligative duhet të qëndrojnë në atë nivel.
3. Vendimin për rezerva tjera eventuale të Shoqërisë të cilat do të formoheshin me ndarjen nga fitimi e nxjerr aksionari, i cili vlerëson që rezervat e tilla janë të nevojshme.

Neni 27

Pasuria e shoqërisë

Pasurinë e përbëjnë e drejta e pronësisë së luajtshme dhe paluajtshme, mjetet financiare dhe letrat me vlerë si dhe të drejtat e tjera pronësore referuar Nenit 5 të Ligjit për Trepçën.

Neni 28

Dispozitat përfundimtare

1. Kohëzgjatja e kësaj Shoqërie nuk është e kufizuar në kohë. Ajo është themeluar për kohë të pacaktuar.
2. Shoqërisë mund ti bashkëngjiten dhe aksionarët tjerë duke depozituar mjete të caktuara dhe duke miratuar Aneks Marrëveshjen për themelim dhe Aneks Statutin e Shoqërisë si dhe kushtet tjera të cilat mund të përcaktohen me Aneks Marrëveshje gjegjësisht Aneks Statut.

Neni 29

Çështjet sociale të punëtorëve

Çështjet sociale të punëtorëve të Trepca SH.A. rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 30

Konflikti i Statutit dhe akteve të Shoqërisë

Aktet e përgjithshme të Shoqërisë duhet të jenë në harmoni me këtë Statut, çdo konflikt ndërmjet Statutit dhe rregulloreve të shoqërisë, Statuti mbizotëron.

Neni 31

Propozimi i Statutit

Ky Statut propozohet nga Bordi Mbikëqyrës, miratohet nga Aksionaret pas aprovimit të Kuvendit të Kosovës.

Neni 32
Regjistrimi i Shoqërisë

Ministria, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, do të ndërmarrë të gjitha veprimet juridike për regjistrimin e Trepça sh.a. në Agjencin e Regjistrimit të Bizneseve pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Marrëveshja për themelim e Shoqërisë hyn në fuqi ditën e regjistrimit të Shoqërisë në ARBK.

Neni 33
Libri i aksioneve

Kryesuesi i Bordit Mbikëqyrës në koordinim me ministrinë, në pajtim Ligjin, do të kryej regjistrimin e anëtarëve të Shoqërisë në Librin e aksioneve në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e regjistrimit të Shoqërisë në ARBK.

Themeluesit:

1. Emri mbiemri/apo emërtimi: _____
2. Emri mbiemri/apo emërtimi: _____